



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.40, datë 26.12.2023

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES TË OBJEKTIT:
“OBJEKT ME FUNKSION HOTEL 8 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE PARKIM
NËNTOKË “WAVE HOTEL”, BASHKIA DURRËS”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 13, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Z.Illir Shtufi, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues të objektit: “Objekt me funksion hotel 8 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë “Wave Hotel”, Bashkia Durrës”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.37, datë 28.12.2020, ndryshuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.21, datë 16.03.2022, nga shoqëria “LTD CO” sh.p.k. në Z. Ilir Shtufi.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

A blue circular official stamp from the Agency for Territorial Development. The text around the perimeter reads "REPUBLIKA E SHQIPERISE" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" on the sides, and "KRYEMINISTRIA" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania. A blue ink signature and the number "23" are written over the stamp.

Nënshkruar më datë 29 / 12 / 2023